



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 06 prill 2020
Nr. Ref.:RK1539/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI85/19

Parashtrues

Bujar Shabani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 6/2019, të 15 prillit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bujar Shabani me vendbanim në Komunën e Ferizajit, të cilin e përfaqëson Muhamet Shala, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [E. Rev. nr. 6/2019] e 15 prillit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenit 6 (E Drejta për një proces të rregullt) dhe nenit 1 Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (në tekstin në vijim: KEDNJ).
4. Objekt i çështjes është gjithashtu kërkesa për masë të përkohshme dhe kërkesa për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 31 maj 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 18 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë plotësim të kërkesës, ku pretendonte se përmes Aktgjykimit të kontestuar i ishte cenuar edhe e drejta e Pronës.
9. Më 26 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë plotësimin e dytë të kërkesës.
10. Më 1 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 1 korrik 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për kontestimin e Aktgjykimit [E. Rev. nr. 6/2019] të 15 prillit 2019 dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
12. Më 1 korrik 2019, Gjykata njoftoi palën e interesuar C. P për regjistrimin e kërkesës duke i dhënë mundësinë e parashtrimit të komenteve brenda 7 ditëve.
13. Më 11 korrik 2019, avokati i palës së interesuar F.L paraqiti në Gjykatë komentet lidhur me rastin.
14. Më 25 nëntor 2019, avokati i palës së interesuar F.L paraqiti në Gjykatë një kërkesë për përsheptimin e vendimmarrjes nga Gjykata, pasi që Gjykata Themelore në Prishtinë –Dega në Lipjan përmes konkluzionit [PPP.nr.40/19] të 28 gushtit 2019 kishte vendosur për shtyrjen e përmbarrimit të kërkesës së kreditorit në afat prej 3 muajve, respektivisht deri më 27 nëntor 2019. Sipas palës së interesuar ekziston rreziku i shtyrjes së procedurës përmbarrimore edhe për një afat tjetër 3 mujor, gjë që do të dëmtonte rëndë interesat e kreditorit C.P dhe dëmet do të ishin të riparueshme.
15. Më 17 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatë plotësimin e radhës të kërkesës ku theksonte se Gjykatat e rregullta nuk e kanë trajtuar fare ekspertizën financiare të Sh.S. sa i përket raportit të dëmit për fitimin e humbur dhe dëmtimit të reputacionit të NTSH “Kosova Asphalt”.
16. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 8 janar 2005, parashtruesi i kërkesës dhe C.P (pala e interesuar), kanë lidhur Kontratën mbi bashkëpronësinë dhe bashkëpunimin në bazë të së cilës kishin themeluar shoqërinë e përbashkët me emrin NTSH "Kosova Asphalt" të tipit Ortakëri e përgjithshme me seli në Lipjan. Për nevojat e këtij biznesi palët kishin blerë edhe makinerinë për prodhimin e asfaltit (në vazhdim: Impiantin). Në vitin 2005 kompania ka filluar aktivitetin ekonomik, përkatësisht prodhimin dhe shitjen e asfaltit. Në ndërkohë marrëdhëniet janë përkeqësuar në mes të palëve deri në atë shkallë sa që veprimtaria e përbashkët ishte pamundësuar dhe se parashtruesi i kërkesës me 29 gusht 2005 e ka larguar palën e interesuar nga vend punishtja, ndërsa me biznesin ka vazhduar të operoj vetëm parashtruesi i kërkesës. Data 29 gusht 2005 është marrë si datë e rëndësishme nga gjykatat në trajtimet e mëvonshme të këtij rasti kontestimor, përkatësisht si datë e ndarjes faktike të ortakëve.
18. Më 6 shtator 2005, kompania pala e interesuar C. P, paraqiti padi pranë Gjykatës Komunale në Lipjan, kundër parashtruesit të kërkesës. Pala e interesuar përmes padisë kërkoi (i) detyrimin e parashtruesit të kërkesës që të ja dorëzoj atij impiantin, ndërsa (ii) në rast të dëmtimit të tij t'ia paguaj edhe kompensimin adekuat për riparimin e tij.
19. Më 30 mars 2006, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kundërpadi ku thekson se me palën e interesuar kanë blerë ngastrën kadastrale [nr.72/8] në Zonën

- kadastrale në Lipjan, me sipërfaqe prej 1 hektarë e 27 ari me ç' rast pala e interesuar i ka mbetur borxh atij në shumën prej 70,000.00 €. Rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës kërkoi që: (i) të refuzohet kërkesëpadia e palës së interesuar; (ii) të detyrohet pala e interesuar që t'ia paguaj shumën prej 52,000.00 €, për mos përmbushje të detyrimit të blerjes së paluajtshmërisë; si dhe (iii) të detyrohet pala e interesuar që t'ia paguaj shumën prej 140,000€, në emër të fitimit të humbur për mos funksionim të fabrikës së asfaltit.
20. Më 28 tetor 2008, Gjykata Komunale në Lipjan përmes Aktgjykimit [C. nr. 364/2005], vendosi të: (I) Zgjidhet kontrata për bashkëpunimin në mes të palës së interesuar dhe të parashtruesit të kërkesës, e lidhur me 8 janar 2005; (II) Vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është pronar i fabrikës "Bernardi" në Lipjan (impiantit për prodhimin e asfaltit) i vendosur në ngastrën kadastrale [nr.72/8] në sipërfaqe prej 1.27.91 ha në vendin e quajtur Gladnica" ZK. Lipjan; (III) Detyroi parashtruesin e kërkesës që palës së interesuar t'ia kompensojë shumën prej 117.170,03€, me kamatë prej 3.5% prej datës 30 janar 2008 kur është dorëzuar ekspertiza financiare si për mjetet e afatizuara me shumë se një vit pa destinim, deri në pagesën definitive; (IV) refuzoi pjesën e kërkesës së palës së interesuar për kompensimin mbi shumën e gjykuar prej 117.170,03€ deri 730,000.00€ për impiantin për shkak të zgjidhjes së kontratës të datës 8 janar 2005; (V) Detyroi ndërgjyqësit, që në mënyrë solidare, gjykatës ti paguajnë shumën prej 100€ për shpenzimet e procedurës.
 21. Në një datë të pacaktuar, pala e interesuar ankohet ndaj Aktgjykimit [C. nr. 364/2005] të 28 tetorit 2008 të Gjykatës Komunale në Lipjan.
 22. Më 31 tetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë përmes Aktgjykimit [AC. nr. 83/2009] e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rigjykim.
 23. Më 21 shtator 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan përmes Aktvendimit [C-Nr. 295/12] caktoi Sh.S. ekspert financiar, për (a) llogaritjen e dëmit material në formë të fitimit të humbur për shkak të mosfunksionimit të Impiantit-Fabrikës për Prodhimin e Asfaltit, kjo sipas vlerësimit të kësaj gjykate e prishur qëllimisht nga ana e palës paditëse me rastin e keqësimit të raporteve ndërmjet tyre dhe atë në periudhën Qershor 2006 deri Tetor 2007, ku duheshin llogaritur dëmi që iu është shkaktuar parashtruesit të kërkesës për shkak të mosrealizimit të kontratave me partnerët tjerë afarist; dhe (b) gjithashtu eksperti të deklarohej edhe për dëmin që i është shkaktuar në prishjen e imazhit, prestigjit dhe besimit të NTSH "Kosova Asfalt", për shkak të mosfunksionimit të Impiantit për periudhën e lartcekur.
 24. Më 22 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan përmes Aktvendimit [C.nr.295/2012] shpallet jo kompetente dhe çështjen e referon tek Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
 25. Më 1 shkurt 2016, pala e interesuar ndërron kërkesën e padisë duke propozuar që Gjykata Themelore të vendosë si në vijim: (i) që ti lejohet tërheqja e palës së interesuar C.P nga NTSH "Kosova Asfalt"; (ii) të detyrohet parashtruesi i kërkesës që t'ia kompensojë palës së interesuar vlerën e investimit në impiant në

shumën që do të specifikohet përmes ekspertizës; dhe (iii) të detyrohet parashtruesi i kërkesës që t'ia kompensojë paditësit shumën prej 50% të fitimit të realizuar gjatë viteve 2005 -2016.

26. Më 23 maj 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti komentet lidhur me pretendimet e palës së interesuar dhe i propozoi Gjykatës Themelore që të marrë Aktgjykim përmes të cilit: (i) zgjidhet kontrata për bashkëpunimin në mes parashtruesit të kërkesës dhe palës së interesuar; (ii) të fshihet pala e interesuar si ortak i subjektit NTSH "Kosova Asfalt"; (iii) të vërtetohet se parashtruesi i kërkesës është pronar i vetëm i paluajtshmërisë të ngastrës kadastrale [nr.72/8] dhe i impiantit që është vendosur në atë ngastër kadastrale; (iv) të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpapia e palës së interesuar me të cilën kishte kërkuar kompensimin e vlerës së impiantit; (v) të detyrohet pala e interesuar që t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës, shumën prej 37.500.00€, në emër të kompensimit të dëmit; dhe (vi) të detyrohet pala e interesuar që shumën prej 117.170.03€ t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës në emër të borxhit kryesor.
27. Përmes kërkesës së Gjykatës Themelore, u angazhua eksperti R. B për vërtetimin e fakteve relevante të kësaj çështje kontestimore si: investimet e ortakëve për hapjen dhe funksionalizimin e biznesit, çmimi blerës i impiantit, fitimet e realizuara para shkëputjes faktike të ortakërisë, fitimet e realizuara pas dëbimit të ortakut C.P nga vend punishtja, detyrimet reciproke të palëve. I njëjti ekspert kishte punuar raportin e ekspertizës më 30 janar 2008 si dhe 2 plotësime të kësaj ekspertize të bëra me 22 nëntor 2017 dhe 18 dhjetor 2017.
28. Më 5 mars 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [EK.nr. 585/16] pranoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit të kundërpaditur (pala e interesuar C. P), kundër parashtruesit të kërkesës, kështu që: I (A) shkëputet marrëveshja e partneritetit e lidhur ndërmjet palëve, duke lejuar tërheqjen nga shoqëria e ortakërisë së përgjithshme të paditësit të kundërpaditur 'Italbeton Ballkan Midle EAST', me përfaqësues ligjor C. P., nga NTSH 'Kosova Asfalt', shoqëri me ortakëri të përgjithshme; I (B) pronar i vetëm i NTSH 'Kosova Asfalt', shoqëri me ortakëri të përgjithshme mbetet parashtruesi i kërkesës, me gjithë pasurinë që dispononte kjo kompani: lëndën e parë, mjetet e punës, duke përfshirë edhe stabilimentet, para së gjithash të gjitha investimet e deri atij momenti ku bën pjesë edhe pasuria e paluajtshme dhe ai mbetet i vetmi person i autorizuar dhe përgjegjës mbi të gjithë aktivin dhe pasivin e kompanisë; I (C) detyrohet parashtruesi i kërkesës që 'Italbeton Ballkan Midle EAST'-it t'ia paguajë shumën prej 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro, në emër të njëjës gjysmë të vlerës së stabilimenteve; I (D) paditësit të kundërpaditur 'Italbeton Ballkan Midle EAST' i njihet e drejta e 50% të fitimit të realizuar në periudhën 2006-2016, në shumën prej 383.497,83 euro dhe e drejta e diferencës së realizuar nga shitja e asfaltit të prodhuar që kap një shumë prej 88.455,40 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 471.952,40 euro; I (E) konstatohet se paditësi i kundërpaditur 'Italbeton Ballkan Midle EAST' ka pasur prapambetje në investime kundrejt parashtruesit të kërkesës gjatë kohës sa ishte pjesë aktive e shoqërisë së ortakërisë (deri më 29.08.2005) me një diferencë prej 382.570,75 euro; I (F) vendoset të bëhet kompensimi i kërkesës si në paragrafin I (D) dhe paragrafin I (E) të këtij aktgjykimi; nga shuma legjitime që do t'ia përkiste ortakut 'Italbeton Ballkan Midle EAST' prej 471.952,40 euro, të zbritet

diferenca në investime prej 382.570,75 euro, që do ti takonte ortakut (parashtruesit të kërkesës). Për këtë arsye, parashtruesi i kërkesës detyrohet që paditësit të kundërpaditur t'ia kompensojë shumën prej 89.000,-euro brenda afatit prej 7 ditësh, llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

29. Në një datë të pacaktuar, pala e interesuar paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit [EK.nr. 585/16] të 5 marsit 2018, për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe çështja të rikthehet në rigjykim.
30. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës gjithashtu paraqiti ankesë kundër Aktgjykimit [EK.nr. 585/16] të 5 marsit 2018, për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ose të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës se shkallës së parë në rigjykim.
31. Në një datë të pacaktuar, pala e interesuar ka parashtruar përgjigje në ankesë me kërkesë që të refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës dhe e njëjta të hudhet poshtë, ndërsa ankesa e tij të aprovohet në tërësi si e bazuar.
32. Më 22 nëntor 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr. 103/2018] fillimisht thekson se me aktgjykimin e shkallës së parë gabimisht është shënuar si paditës 'Italbeton Ballkan Midle EAST' sepse nga të gjitha parashtruesat rezultonte që paditës është C.P (pala e interesuar). Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit ashtu siç rezultonte nga certifikata e regjistrimit të biznesit, ia njohu të drejtat si pronar i përbashkët i Ortakërisë së përgjithshme NTSH "Kosova Asphalt", ortakut C.P. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit pranoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit të kundërpaditur (pala e interesuar- C. P), vetëm për sa i përket detyrimeve dhe të drejtave të palëve të vendosura me pikën I të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [EK.nr.585/16] të 5 marsit 2018, ashtu që pikat (A,B,C,D,E,F) e dispozitivit të këtij aktgjykimi ndryshohet në tërësi dhe nën Pikën I. Gjykohej si në vijim: 1.1 Aprovohen pjesërisht si të bazuara kërkesëpadia e palës së interesuar C.P dhe parashtruesit të kërkesës, që të dy ortak në NTSH "Kosova Asphalt" Ortakëri e përgjithshme dhe gjykohej si në vijim: [1.1.1] Lejohet tërheqja e C.P nga shoqëria tregtare NTSH "Kosova Asphalt" Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, i cili ka të drejtë që nga shoqëria kolektive të tërheq interesin e tij, të përcaktuar me këtë aktgjykim, ndërsa ortakut tjetër Bujar Shabani, detyrohet personalisht ndaj palës së interesuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky aktgjykim; [1.1.2] Vërtetohet se Bujar Shabani, është pronar i vetëm i NTSH "Kosova Asphalt", me të gjitha asetet dhe gjithë kapitalin që posedon kjo shoqëri: lëndën e parë, mjetet e punës duke përfshirë edhe impiantin dhe të gjithë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të shoqërisë së bashku me investimet e kryera si dhe paratë e gatshme dhe si pronar i vetëm tani e tutje është i autorizuari dhe përgjegjësi i vetëm për të gjitha kërkesat dhe detyrimet e shoqërisë kolektive të krijuara deri në momentin e marrjes së këtij aktgjykimi dhe atyre që do të krijohen në të ardhmen; [1.1.3] Detyrohet parashtruesi i kërkesës, personalisht, respektivisht NTSH "Kosova Asphalt" Ortakëri e përgjithshme, me seli në Lipjan, që palës së

interesuar C.P, t'ia paguajnë: në emër të investimeve në shoqëri shumë prej 360,716.43€, në emër të diferencës në realizim nga shitja e asfaltit gjatë vitit 2005 -shumën prej 88,455.40€, dhe në emër të 50% të fitimit të realizuar gjatë viteve 2006-2016 shumë prej 383,497.83€, në shumë të përgjithshme prej 832,668.83€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin prej 7ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi; [II] vërtetohet tërësisht si e pabazuar ankesa parashtruesit të kërkesës dhe pjesërisht si e pabazuar ankesa e palës së interesuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [EK.nr. 585/16] i 5 marsit 2018, në pikat II, III, IV, V dhe VI të dispozitivit, vërtetohen.

33. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion dhe revizion plotësues për: (i) shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe (ii) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të dy aktgjykimet e instancave më të ulëta të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
34. Në një datë të pacaktuar, pala e interesuar parashtrroi përgjigje ndaj revizionit, duke i kundërshtuar pretendimet që ngrihen aty dhe propozon që të refuzohet si plotësisht i pabazuar kurse aktgjykimi i shkallës së dytë të vërtetohet.
35. Më 15 prill 2019, Gjykata Supreme e Kosovës (në tekstin në vijim: Gjykata Supreme) përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 6/2019] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ae.nr. 103/2018] të 22 nëntorit 2018.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 6/2019], duke refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E Drejta për një proces të rregullt) dhe nenit 1 protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ.
37. Parashtruesi i kërkesës e ndërton rastin mbi pretendimin për shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 6/2019] i 15 prillit 2019 nuk i ka plotësuar kriteret për një "gjykim të drejtë" sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së për shkak të: (i) mungesës së shkajshme të arsytimit të vendimit gjyqësor; (ii) vendosjes arbitrare në kundërshtim me të gjitha të gjeturat e ekspertizës gjyqësore financiare duke vendosur lidhur me lartësinë e kërkesës së palës së interesuar; (iii) mos informimit lidhur me seancën e shqyrtimit të Revizionit dhe gjithashtu mos informimit të ekspertit gjyqësor nga lëmia ekonomike dhe financiare i cili do kishte mundur të japë sqarime lidhur me të gjeturat e tij.

38. Për më tepër parashtruesi argumenton që jurisprudenca e GJEDNJ-së e njeh të drejtën e pasjes së një vendimi të arsyetuar duke cituar rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, *Pronia kundër Ukrainës dhe Nechiporuk dhe Tonkalo kundër Ukrainës*. Gjithashtu ai pretendon që rasti *Malta kundër Ukrainës* thirret në precedentët e mëparshëm dhe përforcon rëndësinë që gjykata të japë arsye të detajuara dhe bindëse kur refuzon të merr parasysh një pretendim apo një provë të parashtruar nga një ndërgjyqës.
39. Në fund parashtruesi thekson që edhe praktika e Gjykatës në rastin KI72/12 thirret në precedentë të GJEDNJ-së, përkatësisht në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë dhe Tatishvili kundër Ruisë* dhe ka gjetur se "e drejta në një dëgjim (gjykim) të drejtë përfshin edhe të drejtën në aktgjykim të arsyetuar."
40. Parashtruesi i kërkesës përmend edhe rastin e Gjykatës KI78/12 lidhur me mbështetjen e argumentimit të tij sa i përket çështjes së arsyetimit të vendimit gjyqësor.
41. Parashtruesi i kërkesës thekson gjithashtu se është shkelur edhe parimi kushtetues i paraparë me nenin 24 të Kushtetutës -Barazia para Ligjit, për shkak të vlerësimit arbitrar i cili është në kundërshtim me parimin ligjor se fitimet dhe humbjet shpërndahen njëllë ndërmjet ortakëve në bazë të vlerës së kontributeve të tyre përkatëse. Rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës aspektin e diskriminimit e ndërlidh me mos plotësimin e kriterëve për një gjykim të drejtë.
42. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se i është cenuar e drejta e përcaktuar në nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së (E Drejta e Pronës) duke u shkelur rëndë të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës Bujar Shabani me mos respektimin e parimit se - fitimet do të shpërndahen dhe humbjet do të ndahen njëllë ndërmjet ortakëve në bazë të vlerës së kontributeve të tyre përkatëse. Rrjedhimisht sipas parashtruesit kjo shkelje kushtetuese është e ndërlidhur me nenin 31 të Kushtetutës sepse vendimet gjyqësore të goditura me këtë kërkesë për mbrojtjen e kushtetutshmërisë nuk i kanë plotësuar kriteret për një "Gjykim të Drejtë".
43. Mbi këtë bazë parashtruesi i kërkesës propozon mbajtjen e seancës dëgjimore për shqyrtim në Gjykatë në të cilën parashihet të ftohet eksperti gjyqësor financiar z. Riza Blakaj lidhur me dhënien e sqarimeve profesionale përkatëse për të gjeturat e ekspertizës.
44. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu paraqet edhe kërkesë për masë të përkohshme në mënyrë që të pushojë procedura e përmbarimit deri në zgjedhjen e kërkesës kushtetuese, pasi që vendimi është bërë i plotfuqishëm dhe mund të ekzekutohet në çdo kohë dhe atij i shkaktohet dëm i pariparueshëm.
45. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë asnjë arsye lidhur me ekspertizën gjyqësore nga lëmia financiare të ekspertit Sh.S. sa i përket (a) llogaritjes së dëmit material në formë të fitimit të humbur për shkak të mosfunksionimit të Impiantit në periudhën Qershor 2006 deri Tetor 2007, dhe (b) dëmit që i ishte shkaktuar në prishjen e imazhit,

prestigjit dhe besimit të NTSH "Kosova Asfalt", për shkak të mosfunksionimit të Impiantit për periudhën e lartcekur.

Komentet e palës së interesuar

46. Pala e interesuar thekson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës është i pabazuar pasi që Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj përmban arsyetim të plotë dhe të qartë, si lidhur me provat, faktet dhe bazën juridike të kontestit të zhvilluar tani e 14 vite.
47. Po ashtu, pala e interesuar thekson se pretendimi që palët nuk janë dëgjuar gjatë marrjes së aktgjykimit të Gjykatës Supreme nuk paraqet shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sepse Gjykata Supreme vendos sipas revizionit jashtë seancës dhe kjo është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.
48. Pala e interesuar gjithashtu e kundërshton kërkesën për lejimin e masës së përkohshme duke e konsideruar si të pabazuar për shkak se në radhë të parë "kundër kushtetutshmëria" e pretenduar nga parashtruesi i kërkesës nuk është bërë e besueshme, që mund të shihet fare lehtë me leximin e aktgjykimeve në këtë kontest ekonomik-juridik. Në fund pala e interesuar thekson që Gjykata Kushtetuese nuk është as gjykatë e shkallës së katërt dhe nuk është as gjykatë e faktit, e cila rregullon marrëdhëniet kontraktuale mes palëve prandaj nuk mund të aprovohet propozimi i parashtruesit të kërkesës për dëgjimin e ekspertit financiar.

Dispozitat përkatëse juridike

Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare

Neni 50 Natyra e Interesit në Shoqërinë Kolektive

Interesi i një ortaku të përgjithshëm në shoqërinë kolektive: (i) përfshin të drejtën e ndarjes së fitimit dhe shpërndarjes, si dhe të drejtat e tjera të ortakut të përgjithshëm, dhe (ii) përfshin të drejtat dhe detyrimet e ortakut të përgjithshëm, të përcaktuara të gjitha në këtë Pjesë.

Neni 56 Fitimet, humbjet, alokimet dhe shpërndarja

56.1 Përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë kolektive, të gjithë ortakët e përgjithshëm kanë të drejtë në një ndarje të barabartë të të gjitha fitimeve, humbjeve, alokimeve dhe shpërndarjeve të shoqërisë kolektive.

56.2 Brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik, shoqëria kolektive duhet që të llogarisë dhe regjistrojë të gjitha fitimet apo humbjet e bëra në atë vit, dhe të bëjë ndarjen e përqindjeve të fitimeve ose humbjeve në llogaritë e ortakëve të përgjithshëm.

Neni 63 Tërheqja e një Ortaku

63.1 Ortaku i përgjithshëm mund të tërhiqet nga shoqëria kolektive në çdo kohë duke dorëzuar një njoftim me shkrim për të gjithë ortakëve të tjerë, por nëse tërheqja shkelë marrëveshjen e shoqërisë kolektive, shoqëria kolektive mund të kërkojë kompensim nga ortaku i përgjithshëm për shkelje të marrëveshjes.

63.2 Ortaku i përgjithshëm që tërhiqet nga shoqëria kolektive pa bërë shkeljen e marrëveshjes së shoqërisë kolektive ka të drejtë në fitime, sipas marrëveshjes së shoqërisë kolektive. Përveç nëse marrëveshja e shoqërisë kolektive përcakton ndryshe, ortaku i përgjithshëm i cili tërhiqet ka të drejtë në tërheqjen e interesit të tij në shoqërinë kolektive brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga tërheqja. Ky detyrim është një detyrim që ka shoqëria kolektive ndaj ortakut të përgjithshëm i cili tërhiqet; dhe ortakët e tjerë të përgjithshëm janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi, njëjloj sikurse edhe me detyrimet e tjera të shoqërisë kolektive.

Ligji Nr. 03/L006 për Procedurën Kontestimore

Neni 220

Gjykata Supreme vendosë mbi revizionin, vetëm në bazë të shkresave në dosjen e lëndës, në seancë të trupit gjykues.

Pranueshmëria e kërkesës

49. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

51. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

52. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 6/2019] të 15 prillit 2019 dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
53. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

54. Gjykata fillimisht thekson se bazuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, ajo mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton thelbin e çështjes së ngritur nga parashtruesi i kërkesës dhe pretendimet përkatëse.
55. Sa i përket rastit konkret, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës mund të reduktohen në: (A) shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në

lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, (B) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës; dhe (C) shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së.

(A) Pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

56. Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton që pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të garancive procedurale të "gjykimit të drejtë" të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazohen në: (i) mungesën e skajshme të arsytimit të vendimit gjyqësor; (ii) vendosjes arbitrare në kundërshtim me të gjitha të gjeturat e ekspertizës gjyqësore financiare duke vendosur lidhur me lartësinë e kërkesës së palës së interesuar; (iii) mos informimit lidhur me seancën e shqyrtimit të Revizionit dhe gjithashtu mos informimit të ekspertit gjyqësor nga lëmia ekonomike dhe financiare i cili do kishte mundur të japë sqarime lidhur me të gjeturat e tij.
57. Në trajtimin e pretendimit të parë të parashtruesit së kërkesës që ndërlidhet me të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata do të aplikojë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës ajo, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
58. Prandaj, Gjykata fillimisht do të përcaktojë nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës zbatohet neni 6 i Konventës në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do e përcaktojë zbatimin e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të kësaj Gjykate dhe GJEDNJ-së.
59. Gjykata së pari vëren se fushëveprimi i nenit 6 të KEDNJ-së shtrihet në procedurat që përcaktojnë të "drejtat ose detyrimet civile" (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringeisen kundër Austrisë*, kërkesa nr. 2614/65, Aktgjykim i 22 qershorit 1972). GJEDNJ ka konstatuar se për të qenë neni 6 i aplikueshëm në procedura civile, "(i) duhet të ekzistojë një kontest në lidhje me një 'të drejtë civile', për të cilën mund të thuhet, të paktën në baza të argumentueshme, që është e njohur në të drejtën vendore, pavarësisht se a është e mbrojtur edhe me Konventë. (ii) Kontesti duhet të jetë i vërtetë dhe serioz; ai mund të ndërlidhet jo vetëm me vetë ekzistencën e së drejtës, por edhe me fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të saj; dhe së fundi, (iii) rezultati i procedurave duhet të jetë drejtpërsëdrejti determinues për të drejtën në fjalë; lidhjet e paqarta ose pasojat e largëta nuk janë të mjaftueshme për aktivizimin e nenit 6 paragrafi 1" (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Ivan Atanasov kundër Bullgarisë*, kërkesa nr. 12853/03, Aktgjykim i 2 dhjetorit 2010, paragrafi 90; *Mennitto kundër Italisë*, kërkesa nr. 33804/96, Aktgjykim i 5 tetorit 2000, paragrafi 23; *Giulmez kundër Turqisë*, kërkesa nr. 16330/02, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 28; dhe *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 74).

(A.i) Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

60. Gjykata vëren se përmbajtja e të drejtës së pretenduar në rastin në fjalë, gjegjësisht kërkesa për anulimin e Aktgjykimit [E.Rev.nr.6/2019] të Gjykatës Supreme të 15 prillit 2019 ka të bëjë me anulimin e vendimit lidhur me kontestin e pronësisë dhe vlerës së borxhit të palëve ndërgjyqës të Ortakërisë së përgjithshme NTSH “Kosova Asfalt”. Rrjedhimisht, kjo është një e drejtë e karakterit civil e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
61. Gjykata gjithashtu vëren se kontesti në rastin në fjalë është serioz, i vërtetë dhe ngërthen në vete kontestimin e investimeve të bëra, ndarjen e fitimit të realizuar dhe detyrimeve të Ortakërisë së Përgjithshme NTSH “Kosova Asfalt”. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që edhe ky kriter i praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së është i plotësuar në këtë rast.
62. Së fundmi, Gjykata konstaton që rezultati i procedurave është drejtpërsëdrejti përcaktues lidhur me: (i) atë se kush mbetet përfaqësues ligjor i Ortakërisë së Përgjithshme NTSH “Kosova Asfalt”;(ii) pagesën e shumave të investuara në Ortakëri të Përgjithshme; (iii) ndarjen e pasurisë së kompanisë ku përfshihen: pasuria e paluajtshme, lënda e parë, mjetet e punës duke përfshirë edhe stabilimentet; (iv) ndarjen e fitimeve të kompanisë në periudhën e operimit të Ortakërisë së Përgjithshme. Prandaj, Gjykata konsideron që edhe ky kusht është i aplikueshëm, rrjedhimisht neni 6 i KEDNJ-së është i zbatueshëm në këtë rast.
63. Në këtë aspekt, Gjykata do t’i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, fillimisht sa i përket pretendimeve lidhur me shkeljen e së drejtës për: **(i) vendim të arsyetuar gjyqësor**. Gjykata do të shqyrtojë këto pretendime duke u bazuar në praktikën përkatëse të saj dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe duke e aplikuar të njëjtën në rrethanat e rastit konkret.
64. Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rosisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser*

Husaj, Aktgjykimi i 9 qershorit 2017; KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; dhe KI97/16, parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykimi i 9 janarit 2018.

65. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet “*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (shih rastin e Gjykatës: KI91/18, me parashtrues *Njazi Gashi, Lirije Sadikaj, Nazife Hajdini-Ahmetaj dhe Adriana Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 30 shtatorit 2019, paragrafi 64; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Holandës*, kërkesa nr. 16034/90, Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (Shih rastin e Gjykatës: KI97/17, me parashtrues *Gëzim Sadrijaj, Gazmend Sadrijaj dhe Hidajete Sadrijaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 tetorit 2019, paragrafi 41; shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27). Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm.
66. Megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit - ato megjithatë duhet të adresojnë pretendimet që janë qendrore për rastet e tyre dhe të cilat ngriten në të gjitha fazat e procedurës (Shih rastin e Gjykatës: KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53).
67. Përfundimisht, arsyet e dhëna duhet të jenë të tilla që të mundësojnë palët të përdorin në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të apelimit (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa nr.49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30).
68. Në këtë drejtim, Gjykata do të shtjellojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor përkatësisht të Aktgjykimit [E. Rev. nr. 6/2019] të Gjykatës Supreme të 15 prillit 2019 në rrethanat e rastit konkret, janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
69. Gjykata rikujton që Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [EK.nr. 585/16] të 5 marsit 2018, kishte pranuar kërkesëpadinë e palës së interesuar kundër parashtruesit të kërkesës ku ishte: (i) shkëputur marrëveshja e partneritetit e lidhur ndërmjet palëve, duke lejuar tërheqjen nga shoqëria e ortakërisë së përgjithshme të palës së interesuar; (ii) pronar i vetëm i NTSH 'Kosova Asphalt', shoqëri me ortakëri të përgjithshme mbetej parashtruesi i kërkesës me të gjithë pasurinë që dispononte kjo kompani, (iii) detyrohej parashtruesi i kërkesës që

palës së interesuar t'ia paguajë shumën prej 89.381,65 euro brenda afatit prej 7 ditësh, llogaritur nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

70. Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore përkitazi me caktimin e lartësisë së kompensimit të cilën parashtuesi i kërkesës i detyrohej palës së interesuar. Në arsyetimin e Gjykatës së Apelit thuhet se: *“gjykata e shkallës së parë ka gjetur gabimisht se ortakun i takon vetëm kompensimi i diferencës në shumën prej 89.381,65 euro, duke theksuar se kompensimi do të mund të ishte i drejtë, nëse C.P do të ishte edhe më tutje pronar i 50% të shoqërisë dhe në këtë rast do të ishte i arsyeshëm barazimi i investimeve me ortakun tjetër Bujar Shabani. Mirëpo, ortakun Bujar Shabani, mbas këtij aktgjykimi, bëhet pronar ekskluziv i shoqërisë si dhe investimeve që i ka bërë ortakun tjetër C.P.”* Më tej, Aktgjykimi në fjalë thekson si në vijim: *“do të ishte jashtë çdo logjike që nga ortakun që përjashtohet nga shoqëria të kërkohet të vazhdojë të bëjë investime në mënyrë që të barazohet me investimet e ortakut tjetër, ndonëse nuk do të jetë më pronar i asaj shoqërie, përkatësisht përderisa pronar i vetëm do të mbetet Bujar Shabani. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e goditur në paragrafin I të dispozitivit, duke pranuar në tërësi ekspertizën financiare, por jo edhe interpretimin e gjykatës së shkallës së parë për sa u përket të drejtave dhe detyrimeve mes ortakëve.”*
71. Përfundimisht, Gjykata Supreme gjithashtu trajtoi pretendimet e parashtuesit të kërkesës, të ngritur përmes revizionit për sa i përket pretendimit për (i) shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; dhe (ii) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
72. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 6/2019] të 15 prillit 2019, ndër të tjera, në këtë aspekt kishte theksuar: *“Në fakt, të dy gjykatat e kanë pranuar në tërësi konstatimin e ekspertit financiar, të gjitha vlerat e përcaktuara veç e veç të detyrimeve dhe të drejtave të shprehur në para. Duke pranuar bilancin që ka bërë eksperti, Gjykata e Apelit, nisur nga dispozita e nenit 56.1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (LSHT), sipas të cilit të gjithë partnerët e përgjithshëm kanë të drejtë për pjesëmarrje të barabartë në të gjitha fitimet, humbjet, alokimet (50:50), përveç kur me marrëveshje të partneritetit të përgjithshëm nuk parashikohet ndryshe si dhe nga fakti që Bujar Shabani bëhet pronar i vetëm i 'shoqërisë', ka nxjerrë përfundimin e drejtë se nuk mund të bëhet fjalë për barazim të investimeve dhe se nuk është e mundur që nga shuma e përcaktuar e borxhit të ortakut Bujar Shabani ndaj ortakut C.P, që kap shumën prej 471.952,40 euro, të zbritet diferenca në investime prej 382.570,75 euro, sipas së cilës ai do t'i kishte borxh atij vetëm shumën prej 89.381,65 euro. Ortakun që mbetet pronar i vetëm i shoqërisë, bëhet pronar i tërë kapitalit të saj, duke përfshirë investimet që i ka bërë ortakun tjetër, kështu që ortakun që largohet nga shoqëria nuk ka për detyrim që në këtë shoqëri të investojë para të tjera shtesë. Gjykata e shkallës së dytë duke pranuar konstatimin e ekspertit dhe shumën e përcaktuarë prej tij me anë të operacioneve llogaritare, ka konstatuar me saktësi se paditësit të kundërpaditur, sipas nenit 56 të LSHT i takon: në emër të kapitalit të investuar-investimeve, shuma prej 360.716,43 euro, në emër të ndarjes së barabartë të fitimit, që përfshin diferencën në realizim nga shitja e asfaltit gjatë vitit 2005, shuma prej 88.455,40 euro dhe 50% dhe nga fitimi i*

realizuar gjatë periudhës 2006-2016, shuma prej 383.497,83 euro, që kap shumën e përgjithshme prej 832.668,83 euro. Për këto arsye, janë të pabazuara pretendimet e ngritura në revizion se gjykata e shkallës së dytë i ka përcaktuar arbitrarisht shumat dhe se ka marrë përsipër rolin e ekspertit.”

73. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, se Gjykata Supreme: **ii) kishte vendosur arbitrarisht në kundërshtim me të gjitha të gjeturat e ekspertizës gjyqësore financiare duke vendosur lidhur me lartësinë e kërkesës së palës së interesuar**; nuk qëndrojnë. Kjo sepse, siç është theksuar më lart, gjykatat e rregullta, në mënyrë të vazhdueshme kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e tij me arsye të mjaftueshme në suaza të një gjykimi të drejtë. Lidhur me këtë pretendim në vijim Aktgjykimi i Gjykatës Supreme thekson që: “[...] janë të pabazuara pretendimet e ngritura në revizion se gjykata e shkallës së dytë i ka përcaktuar arbitrarisht shumat dhe se ka marrë përsipër rolin e ekspertit. Pikëpamjen e vet juridike gjykata e shkallës së dytë e ka arsyetuar duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi. Neni 63 i LSHT rregullon rastin e tërheqjes së një partneri. Sipas nenit 63.2 të këtij Ligji 'Ortaku i përgjithshëm që tërhiqet nga shoqëria kolektive pa bërë shkeljen e marrëveshjes së shoqërisë kolektive ka të drejtë në fitime, sipas marrëveshjes së shoqërisë kolektive. Përveç, nëse marrëveshja e shoqërisë kolektive përcakton ndryshe, ortaku i përgjithshëm i cili tërhiqet ka të drejtë në tërheqjen e interesit të tij në shoqërinë kolektive brenda afatit prej 90 ditësh nga tërheqja. Ky detyrim është një detyrim që ka shoqëria kolektive ndaj ortakut të përgjithshëm i cili tërhiqet; dhe ortakët e tjerë të përgjithshëm janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për përmbushjen e këtij detyrimi, njëjloj sikurse edhe me detyrimet e tjera të shoqërisë kolektive.’
74. Përfundimisht, Gjykata Supreme theksoi që: “Nga sa u parashtrua rezulton se gjykatat e instancës së ulët i janë referuar drejt të drejtës materiale përkatësisht dispozitave të neneve 50, 56 dhe 63 të LSHT, duke i zbatuar dispozitat e përgjegjësisë së përbashkët në ndarjen e fitimit, të humbjeve, alokimeve si dhe pasojave, të drejtave dhe të detyrimeve në rast të tërheqjes nga 'shoqëria' të një partneri. Në të gjitha aspektet e tjera, Gjykata Supreme e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj arsyetimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës.”
75. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës pati një mundësi efektive për të kundërshtuar vërtetësinë e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre dhe se këtë mundësi e shfrytëzoi gjatë procedurës para gjykatës së shkallës së parë, në ankesën e saj në gjykatën e Apelit dhe në revizion para Gjykatës Supreme. Gjykatat e rregullta i shqyrtuan argumentet e tij mbi bazueshmërinë dhe dhanë arsye për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së: *Dragojević kundër Kroacisë*, kërkesa nr. 68955/11, Aktgjykim i 15 janarit 2015, paragrafi 132). Fakti që parashtruesi i kërkesës ishte i pasuksesshëm në secilin hap nuk e ndryshon faktin që ai pati një mundësi efektive për të kundërshtuar provat dhe përdorimin e tyre.
76. Gjykata gjithashtu vëren se për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për mos trajtim të çështjes së raportit të ekspertizës financiare të Sh.S (e cila përfshinte çështjen e fitimit të humbur dhe dëmtimit të reputacionit dhe

imazhit të NTSH “Kosova Asfalt” gjatë periudhës qershor 2006 deri tetor 2007), Gjykatat e rregullta kishin konkluduar që (i) data 29 gusht 2005 ishte data e ndarjes faktike të ortakëve dhe (ii) pas kësaj date vetëm parashtruesi i kërkesës ka vazhduar me operimin dhe menaxhimin e biznesit si i vetëm.

77. Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, respektivisht Gjykata Supreme, si instancë përfundimtare e gjyqësorit të rregullt ka dhënë arsye gjithëpërfshirëse dhe të detajuar dhe i është përgjigjur veç e veç secilit pretendim të ngritur nga parashtruesi i kërkesës në revizion.
78. Andaj, nga sa u tha më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t’i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih rastet e Gjykatës: KI24/19, me parashtrues *Valon Miftari*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 tetorit 2019, paragrafi 34; KI88/18, me parashtruese *Hysnije Dedinca*, Akvendim për papranueshmëri i 28 tetorit 2019, paragrafi 38; Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
79. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata përsërit që nuk është funksion i Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e pretenduara në aplikimin e ligjeve përkatëse që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, nëse me këtë aplikim nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin e Gjykatës: KI24/19, me parashtrues *Valon Miftari*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 tetorit 2019, paragrafët 31 dhe 33; Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
80. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në kuptim të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, është detyrim i gjykatave që argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës të adresohen dhe arsyet e dhëna të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm. Gjykata konsideron se sa i përket pretendimit konkret, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Supreme, Aktgjykimi i të cilit kontestohet në Gjykatë, e kanë përmbushur këtë detyrim.
81. Përfundimisht, Gjykata do t’i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sa i përket pretendimeve lidhur me (iii) *mos informimin lidhur me seancën e shqyrtimit të Revizionit dhe gjithashtu mos informimit të*

ekspertit gjyqësor nga lëmia ekonomike dhe financiare i cili do kishte mundur të japë sqarime lidhur me të gjeturat e tij.

82. Gjykata vëren se përderisa dëgjimi publik përbën një parim themelor të parashikuar në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, detyrimi për të mbajtur një seancë të tillë nuk është absolut (Rasti i GJEDNJ-së: *De Tommaso kundër Italisë*, kërkesa nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafi 163). E drejta për një seancë dëgjimore nuk lidhet vetëm me pyetjen nëse procedurat përfshijnë marrjen në pyetje të dëshmitarëve që do të japin provat e tyre gojarisht (*Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, kërkesat nr. 55391/13, 57728/13 dhe 74041/13, Aktgjykim i 6 nëntorit 2018, paragrafi 187). Për të vërtetuar nëse një gjykim përputhet me kërkesën e publicitetit, është e nevojshme të merren parasysh procedurat në tërësi (*Axen kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8273/78, Aktgjykim i 8 dhjetorit 1983, paragrafi 28).
83. Mungesa e seancës dëgjimore në shkallë të dytë ose të tretë mund të justifikohet nga veçoritë e veçanta të procedurave në fjalë, me kusht që seanca të jetë mbajtur në shkallë të parë (*Helmerts kundër Suedisë*, kërkesa nr. 11826/85, Aktgjykim i 29 tetorit 1991, paragrafi 36; *Salomonsson kundër Suedisë*, kërkesa nr. 38978/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36). Kështu që, proceset gjyqësore të ankesave që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, në kundërshtim me çështjet faktike, mund të përputhen me kërkesat e nenit 6 edhe pse parashtruesit nuk iu dha një mundësi për t'u dëgjuar personalisht nga gjykata e apelit (*Miller kundër Suedisë*, kërkesa nr. 55853/00, Aktgjykim i 8 shkurtit 2005, paragrafi 30). Prandaj, duhet të merren parasysh veçantitë e procedurave në gjykatat më të larta.
84. Prandaj, përveç nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që justifikojnë përjashtimin e një seancë dëgjimore (shiko përmbledhjen e praktikës gjyqësore në *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë*, cituar më lartë, paragrafi 190), e drejta për një dëgjim publik sipas nenit 6 paragrafit 1 nënkupton një të drejtë për një seancë dëgjimore të paktën në një nivel të juridiksionit (Rasti i GJEDNJ-së: *Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 16922/90, aktgjykim i 26 prillit 1995, paragrafi 44; *Salomonsson kundër Suedisë*, kërkesa nr. 38978/97, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 36).
85. Në rrethanat e rastit konkret Gjykata konsideron që (iii) mos informimin lidhur me seancën e shqyrtimit të Revizionit, përkatësisht vendosja e Gjykatës Supreme mbi revizionin vetëm në bazë të shkresave në dosje të lëndës, në seancë të trupit gjykues është në përputhje me nenin 220 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjithashtu është në linjë me praktikën e GJEDNJ-së e cila ka zbatim të drejtpërdrejtë në juridiksionin e Kosovës.
86. Përfundimisht, duke u bazuar në elaborimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret procedurat ishin të drejta dhe nuk konsistojnë në marrjen e një vendimi të paarsyetuar dhe arbitrar. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

(B) shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës

87. Parashtruesi i kërkesës thekson gjithashtu se është shkelur edhe parimi kushtetues i paraparë me nenin 24 të Kushtetutës -Barazia para Ligjit, për shkak të vlerësimit arbitrar i cili është në kundërshtim me parimin ligjor se fitimet dhe humbjen shpërndahen njëjloj ndërmjet ortakëve në bazë të vlerës së kontributeve të tyre përkatëse.
88. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastin e Gjykatës nr. K198/13, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 marsit 2014, Rasti KI136/16, parashtrues: *Ibrahim Svarça*, Aktvendim për Papranueshmëri i 4 nëntorit 2016, paragrafi 43).
89. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 13 qershorit 1979 *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, paragrafi 33).
90. Gjykata rikujton, që fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrëjë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr.5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
91. Në bazë të të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstaton si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës për trajtim diskriminues ndaj tij.

(C) Pretendimi për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.

92. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu thekson që vendimi i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së duke iu shkelur rëndë të drejtat pronësore të tij me mos respektimin e parimit se - fitimet do të shpërndahen dhe humbjet do të ndahen njëjloj ndërmjet ortakëve në bazë të vlerës së kontributeve të tyre përkatëse.
93. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *Vander Mussele kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
94. Gjykata vëren se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) i KEDNJ-së vlen vetëm për "zotërimet" ekzistuese të një personi (shih *Marckx kundër Belgjikës*, paragrafi 50, Aktgjykim i 13 qershorit 1979; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* paragrafi 64).

95. Parashtruesi i kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për aq sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e tij; brenda kuptimit të kësaj dispozite "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë "pritshmëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.
96. Në rrethana të caktuara, një "pritje legjitime" për të marrë një pronë mundet gjithashtu të gëzojë mbrojtje nga Neni 1 i Protokollit Nr.1 të KEDNJ-së (*Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 17849/91, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31; *Grazinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 39794/98, Vendim për papranueshmëri i 10 korrikut 2002, paragrafi 73).
97. Por, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme (lidhur me konteste pronësore) dhe atje ku parashtruesat e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih: *Kopecky kundër Sllovakisë*, paragrafi 50 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së të 28 shtatorit 2004).
98. Procedurat në lidhje me një kontest civil midis palëve private nuk marrin përsipër vetë përgjegjësinë e Shtetit sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Mateos kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13021/87, Vendimi i Komisionit i 8 shtatorit 1988, f. 268 dhe 275; *Gustafsson kundër Suedisë*, kërkesa nr. 15573/89, Aktgjykim i 25 prillit 1996, paragrafi 60; *Skowronski kundër Polonisë*, kërkesa nr. 52595/99, Aktgjykimi i 17 shkurtit 2004; *Kranz kundër Polonisë*, kërkesa nr. 6214/02, Aktgjykim i 17 shkurtit 2004; *Eskelinen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 7274/02, Vendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2004; *Tormala kundër Finlandës*, kërkesa nr. 41258/98, Aktvendim për papranueshmëri i 16 marsit 2004; *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, kërkesa nr. 16812/17, Aktgjykim i 18 korrikut 2019, paragrafi 310).
99. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, fakti i thjeshtë që Shteti, përmes sistemit të tij gjyqësor, siguron një forum për përcaktimin e një mosmarrëveshje të së drejtës private nuk cilësohet si ndërhyrje nga Shteti me të drejtat e pronës sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (Shih rastin: *Kuchař dhe Štis kundër Republikës Çeke*, kërkesa nr. 37527/97, vendimi i Komisionit i 21 tetorit 1998), edhe nëse rezultati thelbësor i një gjykimi të dhënë nga një gjykatë civile rezulton në humbjen e "zotërimeve" të caktuara. Sidoqoftë, është pjesë e detyrave të Shteteve, sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1, të paktën të krijojnë një kornizë minimale legjislative, duke përfshirë një forum të duhur, duke lejuar ata që pretendojnë se e drejta e tyre ishte shkelur për të kërkuar të drejtat e tyre në mënyrë efektive dhe ato ti zbatojnë. Duke mos arritur ta bëjë këtë, një Shtet do të dështonte seriozisht detyrimin e tij për të mbrojtur sundimin e ligjit dhe për të parandaluar arbitraritetin (shih rastin e GJEDNJ-së: *Kotov kundër Rusisë*, kërkesa nr. 54522/00, Aktgjykim i 3 prillit 2012, paragrafi 117).

(C. i) aplikimi i parimeve të përmendura në rastin konkret

100. Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohen konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur sepse Gjykata Supreme e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur në favor të kërkesëpadsisë së tij.
101. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesi ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës, përkatësisht që me Aktgjykimin e kontestuar parashtruesit të kërkesës i është mohuar realizimi i të drejtës së tij.
102. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar fakte që do të tregonin se vendimet e gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë kanë shkaktuar shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.
103. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 paragrafi (2) të Rregullores së punës.

Kërkesa për mbajtje të seancës dëgjimore

104. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka kërkuar nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore.
105. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në bazë të paragrafit 1 të rregullit 42 të Rregullores së punës, *"Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës, përveç nëse Gjykata, me shumicë votash, vendos ndryshe pas një arsyetimi të mirë"*, ndërsa në bazë të paragrafit 2 të po të njëjtit rregull, *"Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit"*.
106. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Për më tepër, Gjykata thekson se, bazuar në rregullin e lartcekur, vetëm rastet të cilat shpallen të pranueshme dhe shqyrtohen meritat përkatëse mund të dëgjohen para Gjykatës përmes seancës dëgjimore. Rregullorja e punës i mundëson Gjykatës që përjashtimisht të bëjë një gjë të tillë edhe në raste kur një kërkesë nuk është e pranueshme, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret. Megjithatë, Gjykata rikujton që bazuar në paragrafin 2 të rregullit 42 të Rregullores së punës, ajo mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur ajo beson se është e nevojshme për të qartësuar çështjet e provave apo ligjit. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti sepse Gjykata nuk konsideron se ka ndonjë paqartësi rreth *"provave apo ligjit"* dhe për këtë arsye nuk e sheh të nevojshme mbajtjen e seancës dëgjimore.

Dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast (Shih rastin e Gjykatës: KI147/18, me parashtrues *Arbër Hadri*, Aktvendim për papranueshmëri i 11 tetorit 2019, paragrafi 64).

107. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

108. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkoi vendosjen e masës së përkohshme përmes së cilës do të ndalohej pagesa e shumës për të cilën detyrohej deri në vendosjen meritorë të çështjes nga kjo Gjykatë.
109. Gjykata tani më konstatoi se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese.
110. Prandaj, në pajtim me nenin 27.1 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 57 (4) (a) të Rregullores, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme duhet të refuzohet, sepse e njëjta nuk mund të jetë objekt shqyrtimi, pasi kërkesa deklarohet e papranueshme (Shih në këtë kontekst rastin e Gjykatës: KI19/19 dhe KI20/19, parashtrues *Muhamed Thaqi* dhe *Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri i 26 gushtit 2019, paragrafët 53-55).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe 27 të Ligjit dhe rregullat 39 (2), 42, 57 dhe 59 (2) të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. TË REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;
- IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- V. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VI. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi